VENDIM
Nr. 752, datë 19.12.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

(ndryshuar me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë pas botimit të tij në "Fletoren zyrtare".
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

RREGULLORE
E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.
2. Bordi i apelit (në vijim BA) është organ i krijuar në bazë të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, (në vijim ligji) dhe shqyrton çështjet e zgjidhjes së konflikteve që lidhen me pronësinë dhe të drejtat mbi objektet e PI-së.

Neni 2
Përbërja, emërimi dhe lirimi i anëtarëve të BA-së

(ndryshuar pika 1, ndryshuar fjalë në fjalinë e parë të pikës 3 dhe 4 me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

1. Bordi i Apelit përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë punonjës të DPPI-së dhe 3 anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së.
2. Kryetari i BA-së është drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Kandidatët për anëtarë në BA, nga radhët e punonjësve të DPPI-së, si dhe 3 anëtarët e jashtëm të përzgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm nga kandidaturat e paraqitura, i propozohen për miratim këshillit mbikëqyrës, në fillim të çdo viti kalendarik, nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, për emërim si anëtarë të BA-së. Drejtori i Përgjithshëm, gjithashtu, e njeh këshillin mbikëqyrës me të gjitha kandidaturat që plotësojnë kushtet e pikës 1, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, si dhe me arsyet e përzgjedhjes.

4. Në muajin nëntor të çdo viti do të shpallen tre vende vakante për vitin e ardhshëm kalendarik, për anëtarët e jashtëm të BA-së. Shpallja e vendeve vakante do të bëhet me njoftim në faqen zyrtare web të DPPI-së.

5. Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i jashtëm i BA-së duhet të nënshkruhet nga vetë kandidati dhe duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Të dhënat mbi identitetin personal, adresë korrespondence, e-mail dhe çdo pikë të saktë kontakti tjetër të parashikuar me ligj;

b) Jetëshkrim;

c) Diplomë e ciklit të dytë të studimeve "Master shkencor";

ç) Çdo dokument tjetër që provon kontributin dhe njohuritë në fushën e PI-së.

Dokumentet e shkronjave "c" dhe "ç", të kësaj pike, që nuk do të jenë origjinale ose të noterizuara, do të konsiderohen të padepozituara. DPPI-ja nuk do të dërgojë njoftim për plotësim dokumentacioni.

Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i BA-së, e pashoqëruar me dokumentet përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", e "ç", të kësaj pike, do të konsiderohet e padorëzuar dhe, si e tillë, nuk do të shqyrtohet.

6. Lirimi i anëtarëve të BA-së bëhet nga këshilli mbikëqyrës për këto arsye:

a) Çdo anëtar i BA-së do të konsiderohet i liruar në fund të vitit kalendarik, me të drejtë riemërimi;

b) Me kërkesën e tij për dorëheqje;

c) Kur i është ndaluar ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) Kur cenon më shumë se një herë, në mënyrë të pajustifikuar, detyrimet që lindin në bazë të kësaj rregulloreje;

d) Me vendim të këshillit mbikëqyrës, për shkelje të rregullave të etikës.

7. Anëtari i BA-së, që jep dorëheqjen, sipas shkronjës "c", të nenit 193/c, të ligjit, është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes, të paktën një muaj përpara datës së lirimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur.

8. Mbledhja për shqyrtimin e çështjes së lirimit të anëtarit të BA-së thirret nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

Mbledhja për shqyrtimin e lirimit të anëtarit të BA-së nuk zhvillohet pa e thirrur atë të marrë pjesë dhe të paraqesë shpjegimet e tij, përveç rastit kur kjo nuk është e mundur.

Vendimi i marrë në këtë mbledhje është i formës së prerë dhe zbatohet menjëherë.

9. Kryetari i BA-së dhe këshilli mbikëqyrës marrin masa për zëvendësimin sa më të shpejtë të anëtarit të liruar nga detyra, duke shpallur vendin vakant në faqen web të DPPI-së dhe duke proceduar si në pikat 4 e 5, të këtij neni. Afatet e procedimit në këtë rast përcaktohen nga kryetari i BA-së. Për çdo rast, këto afate nuk mund të jenë më të shkurtra se 7 (shtatë) ditë.

Neni 3

Sekretari teknik

1. Mbledhjet e BA-së asistohen nga sekretari teknik. Drejtori i Përgjithshëm cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik në fillim të çdo viti kalendarik.

2. Sekretari teknik i BA-së është punonjësi i DPPI-së i cili ushtron këto detyra:

a) Merr në dorëzim me firmë të drejtorit të Përgjithshëm, dosjen e kërkesës së depozituar për shqyrtim pranë BA-së;

b) Është personi i autorizuar që konstaton fillimisht këto mangësi dhe dërgon njoftime për plotësimin e mangësive dhe/ose pasaktësive të kërkesës;

c) Njofton palët të depozitojnë pranë BA-së argumentet, prapësimet dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores së patentave, rregullores së disenjove industriale, rregullores së markave, rregullores së treguesve gjeografikë, rregullores së tarifave;

ç) Mban procesverbalin e mbledhjes me të gjitha elementet që duhet të përmbajë procesverbali, si dhe detyra të tjera të ngarkuara nga BA-ja.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditësh nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara me ligj, sekretari teknik një kopje të dosjes së plotë ia dërgon secilit anëtar të BA-së për njohje.

4. Sekretari teknik pasi merr nga drejtori i Përgjithshëm urdhrin për datën e mbledhjes së BA-së, ua komunikon atë së bashku me rendin e ditës anëtarëve me e-mail dhe/ose telefon.

Neni 4

Mbledhja e BA-së dhe vendimmarrja

(ndryshuar pika 6 me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

1. Mbledhjen e BA-së e çel kryetari.

2. Përpara fillimit të shqyrtimit të çdo çështjeje të re, sekretari teknik paraqet verbalisht përpara BA-së një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, fakteve dhe provave të depozituara në lidhje me çështjet dhe mban procesverbalin e mbledhjes dhe të diskutimeve të anëtarëve.

3. BA-ja, nën drejtimin e kryetarit, shtron për diskutim me radhë të gjitha çështjet që janë vendosur në rendin e ditës.

4. Në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit dhe të shkëmbimit të opinioneve nga anëtarët e BA-së, kryetari i fton anëtarët të votojnë. Së pari voton anëtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimmarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin.

5. Në rast se rreth një çështjeje propozohen disa zgjidhje dhe votimi i parë është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare në përputhje kjo me nenin 15, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

6. Kryetari i Bordit të Apelit cakton një anëtar të Bordit të Apelit, që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, të përgatitë vendimin e arsyetuar, një kopje e të cilit i dorëzohet sekretarit teknik nëpërmjet zyrës së protokollit për t'ia bashkëlidhur dosjes së çështjes.

7. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e BA-së që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën "kundër" dhe nënshkruan vendimin.

8. Vendimi i marrë i dorëzohet zyrës së protokollit të DPPI-së, për t'ia njoftuar atë palëve.

Neni 5

Shpërblimi i anëtarëve të BA-së

1. Kryetari, anëtarët dhe sekretari teknik i BA-së do të përfitojnë shpërblim për çdo mbledhje të BA-së.

2. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të BA-së është i barabartë në shumën 15 000

(pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.

3. Shpërblimi i sekretarit teknik është i barabartë me shumën 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.

4. Shpenzimet që parashikohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje janë parashikuar të mbulohen nga buxheti i DPPI-së, si agjenci autonome.